

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN RAJONALE TË ISHMP FIER**

Raporti përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Degën Rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe vlerësues” për periudhën e veprimtarisë nga data 1.01.2014 deri me datë 31.08.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr.183, datë 31.12.2015

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. 807/9, datë 31.12.2015, dërguar z.Agron Bashalliu Drejtor në Degën Rajonale të ISHMP Fier, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

#### ***1. Gjetje nga auditimi***

Gjatë auditimit të raporteve të vetmonitorimit të treguesve në mjedis të subjekteve me leje mjedisore, u konstatuan parregullsi të cilat kishin mangësi në periodicitetin e raportimit si dhe në përputhshmërinë me kërkesat e lejeve dhe të legjislacionit në fuqi.

*Me synim mbrojtjen e mjedisit dhe ndëshkimin e operatorëve që nuk zbatojnë detyrimet e akteve rregullative në fuqi, rekomandoj:*

-DR ISHMP Fier të ketë komunikim zyrtar periodik me DRM Fier dhe AKM për çdo vlerësim të Raporteve të vet monitorimit me konstatime të parregullive, për zonën në administrim dhe inspektim të DR ISHMP Fier, për efekt të sanksionimit të tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

*Në vazhdimësi*

#### ***2. Gjetje nga auditimi***

DR ISHMP Fier nuk ka kryer inspektime në terren për masat e marra nga Kompania .....për eliminimin e ndotjes së shkaktuar nga funksionimi i aktiviteteve të saj, jashtë kushteve të lejeve mjedisore, për të cilat kjo kompani ka marrë një urdhër pezullimi deri në plotësimin e rekomandimeve të lëna nga inspektimi me shkresën e Ministrit të Mjedisit nr.1389, datë 27.02.2015 “ Raport Përfundimtar i Inspektimit dhe masat e detyrueshme për zbatim”, por që nga informacioni dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion nga DR ISHMP Fier, kësaj kompanie i është ndërprerë pezullimi me urdhrin nr. 132/1, datë 23.04.2015 dhe nr. protokollit 2439/1 “ Për mbarimin e pezullimit të aktivitetit dhe dhënies së lejes mjedisore me nr. identifikues nr. 1120, vendimi nr.6, datë 24.04.2013” grupa ekologjike nr.8 të subjektit ..... lëshuar nëpërmjet QKR. Gjithashtu theksojmë se nga DRISHMP Fier nuk u vu në dispozicion dokumentacion, që bën vlerësimin prej saj apo nga institucioni qendror i ISHMP, të realizimit të masave dhe detyrave të lëna nga inspektimi i kryer me urdhër të Ministrit.

Në lidhje me gjobat e vendosura kompanisë në vitin 2014 ka rezultuar, se DRISHMP Fier, për periudhën e aktivitetit të saj për vitin 2014 dhe vitin 2015 nuk ka të arkëtuar asnjë gjobë, pasi gjykata nuk ka nxjerrë titullin ekzekutiv për gjobën 5,000,000 lekë si rezultat i mangësive në dokumentacionin e paraqitur dhe jo konform kërkesave ligjore, ndërsa për gjobën 2,000,000 lekë DR ISHMP Fier nuk i është drejtuar gjykatës për nxjerrjen e titullit ekzekutiv.

Gjithashtu është konstatuar se DR ISHMP Fier në vlerësimin e masave të marra nga kompania mbas ndotjes aksidentale, është mjaftuar vetëm me njoftimin e bërë me shkresën nr. 492, datë 6.04.2015, ku njoftohet inspektorati për masat e kompanisë për vlerësimin e dëmeve dhe

kryerjen e ekspertizave përkatëse me ekspertë të kontraktuar nga ana e saj, marrjen e masave për dëmshpërblimin e banorëve si dhe kryerjen e punimeve për rehabilitimin e mjedisit të ndotur. *DR ISHMP Fier nuk ka kryer inspektime apo verifikime për sa kompania ka informuar, duke mos kryer detyrimet konform kërkesave ligjore dhe funksionale të saja, sa trajtuar në faqet 97 -102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për këtë rekomandoj:***

**a-**DR ISHMP Fier, në bashkëpunim me ISHMP dhe institucionet e tjera, konform përcaktimeve ligjore, të marrë masa konkrete për vlerësimin në terren të masave të marra nga Kompania ..... në drejtim të rehabilitimit të mjedisit nga ndotja, duke vlerësuar rehabilitimin konkret apo me plan masash dhe afatesh të kompanisë dhe të ndjek në vijimësi nivelin e realizimit të tyre.

**b-** Verifikimin e dëmshpërblimit të banorëve sipas vlerësimeve të dëmeve të miratuara nga organet përkatëse.

**c-** Verifikimin e funksionimit aktual të Kompanisë konform lejeve të rivlerësuar dhe miratuara sipas procedurave ligjore në fuqi (pra nëpërmjet AKM) dhe procedimin konform ligjit për çdo shkelje të konstatuar rishtas.

**d-** Nxjerrjen e titujve ekzekutivë për dy gjobat e vendosura kompanisë gjatë vitit 2014, duke plotësuar dhe dorëzuar në gjykatë dokumentacionin ligjor konform ligjit.

**e-** *Mbajtjen e përgjegjësisë ligjore në rastin e shuarjes së gjobave të vendosura kompanisë konform nenin 44 “ Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ” të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” për rastet e kalimit të afateve ligjore të gjykimit dhe rrëzimit të vendimeve administrative për mangësi dokumentimi.*

***Menjëherë***

***3. Gjetje nga auditimi***

Nga evidenca e grumbulluar dhe raportimet e subjektit rezultojnë, se DR ISHMP Fier nuk ka hartuar strategji afatmesme apo vjetore, ku të përcaktohen objektivat sipas prioriteteve që duhet të arrijë, për plotësimin e misionit të ngarkuar nga kuadri rregullator në fuqi, por veprimtarinë e saj e ka kryer duke u mbështetur në plane pune mujore me mundësi rastësore të planifikimit të inspektimeve, pa u mbështetur në një analizë të mirëfilltë e reale të mundësive, faktorëve që suportojnë dhe atyre që bëhen pengesë, madhësisë së territorit dhe veçorive të zonës referuar karakteristikave të mjedisit dhe pyjeve, mundësisë së bashkëpunimit me aktorë të tjerë. Gjithashtu në institucion nuk ka një strategji të miratuar të riskut dhe nuk janë përcaktuar procedura të menaxhimit të riskut, nuk ekziston regjistri i identifikimit të risqeve dhe menaxhimit të tyre, *sa trajtuar në faqet 92-96 të Raportit përfundimtar të Auditimit.*

***Për këtë rekomandoj:***

Kryeinspektori i DR ISHMP Fier, në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues dhe Përgjegjësit e Sektorëve, në bazë analizës së punës së institucionit dhe të rezultateve të saj, të hartojë strategjinë afatmesme dhe atë vjetore për vitin 2016, duke përcaktuar objektiva konkret dhe të matshëm të veprimtarisë së institucionit. Në këtë kuadër të vlerësohen ngjarjet apo fushat që parashikohen me risk për arritjen e objektivave, të renditen në një strategji të identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të riskut si dhe të caktohet koordinatori i riskut për ndjekjen e procesit në vazhdimësi, sipas përcaktimeve të MFK. Ndër objektivat kryesore të vlerësohet

mundësia e përfshirjes së rifreskimit të rregullores së brendshme të institucionit, duke reflektuar në të kërkesat specifike të ligjit për MFK dhe akteve të tjera në fuqi.

*Menjëherë*

#### **4. Gjetje nga auditimi**

Referuar faktit se nga DR ISHMP Fier nuk është hartuar pyetëtori dhe dokumenti i deklaratës së vetëvlerësimit dhe raporti i cilësisë, i cili dërgohet ISHMP Qendror dhe Ministrisë së Mjedisit, referuar nenit 18 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, për efekte të plotësimit me rigorozitet të kërkesave ligjore, duke pasur në konsideratë se këto dokumente japin opinione të rëndësishme mbi funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit brenda institucionit, *sa trajtuar në faqet 92-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:*

-Nga Inspektorati duhet që në deklaratimet për vitin 2015, të cilat bëhen brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës në institucionet përkatëse, në plotësim të kërkesave ligjore, të dorëzohet pyetëtori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit së bashku me deklaratën dhe raportin e cilësisë.

*Në vazhdimësi*

#### **5. Gjetje nga auditimi**

Referuar konstatimit nga auditimi, se në DR ISHMP Fier nuk kishte rregulla të brendshme të miratuara për gjurmët e auditimit, për procedurat standarde të përdorimit të fondeve buxhetore për shpenzimet për paga, shpenzimet operative sipas llojit, për administrimin e aseteve dhe materialeve të institucionit, si dhe të rregullave të procedurave të prokurimit publik, me synim që të sigurohet se të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë që u mundëson audituesve të brendshëm e të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit, *sa trajtuar në faqet 92-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:*

-Nga N/A dhe Titullari i institucionit, ku aktualisht në DR ISHMP Fier Nëpunësi Autorizues është dhe Titullar institucioni, në zbatim të nenit 9, pika 2 dhe nenit 16, pika 2, të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të hartohen dhe të miratohen rregullat për gjurmët e auditimit, për procedurat standarde të shpenzimeve, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Financave në zbatim të Ligjit.

*Menjëherë*

#### **6. Gjetje nga auditimi**

Nga auditimi për periudhën objekt auditimi është konstatuar se, zyra e financës së DR ISHMP Fier ka paguar detyrimet për shërbim postar pa konfirmuar dokumentin e akt rakordimit me ..... Për efekt të shmangies së pagesave për shërbime të pa kryera, *sa trajtuar në faqet 72-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:*

-Nga zyra e financës së institucionit, referuar udhëzimeve të Ministrisë së Financave në fuqi, për një menaxhim sa më efektiv të fondeve buxhetore, të kryej pagesat vetëm mbas sigurimit të dokumentacionit vërtetues të mjaftueshëm të kryerjes së shërbimit.

*Menjëherë*

#### **7. Gjetje nga auditimi**

Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve ka rezultuar se, DR ISHMP Fier, e cila kryen veprimtarinë e saj në dy ambiente, ku njëri është i marrë me qira, nuk ka kryer pagesa për energjinë elektrike për vitin 2014 dhe vitin 2015 referuar detyrimin paraprak të nxjerrë nga sistemi, në masën 87,722 lekë. Gjatë periudhës së auditimit..... ka bërë ndërprerjen e

energjisë elektrike në ambientin pronë shtetërore të institucionit. Për të shmangur kamat vonesat e mëtejshme, *sa trajtuar në faqet 72-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:*  
a-Nga DR ISHMP Fier të realizohet rakordimi dy palësh me ..... dhe të kryhen pagesat për detyrimet dhe kamat vonesat e konstatuara. Për kamat vonesat e vendosura, mbas pagimit të tyre, të nxirret përgjegjësia nga titullari i institucionit dhe të kryhet arkëtimi i shumave nga punonjësit përgjegjës.

*Menjëherë*

**b**-Gjithashtu referuar citimit në nenin 5, paragrafi i tretë, të kontratës së lidhur me nr. 256, datë 27.03.2015, “Për marrje ambientesh me qira deri në fund të vitit 2015”, në të cilën theksohet se: “Qiramarrësi është i detyruar të paguajë detyrimisht faturat e energjisë elektrike dhe faturat e Ujësjellës Kanalizime në kohë dhe sasi” dhe faktit të konstatuar të mos pagesës së asnjë detyrimi deri në 8 mujorin e vitit 2015, rekomandojmë bashkëpunimin me kontraktuesin për saktësimin e ekzistencës së këtyre detyrimeve dhe pagesën e tyre në mënyrë të menjëhershme .

*Menjëherë*

### **8. Gjetje nga auditimi**

Referuar faktit të konstatuar nga auditimi se në fletë udhëtimet e mbajtura nuk janë evidentuar destinacionet përfundimtare të udhëtimit në rrethet përkatëse, duke u nisur dhe nga specifikat që ka ky inspektorat në inspektimin në mjedis, pyje (pra destinacione larg qendrave urbane), për efekt të shmangies së interpretimeve jo të bazuara në dokumente dhe jo korrekte me aktet në fuqi, *sa trajtuar në faqet 80-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:*

**a-** Të bashkëpunohet me Ministrinë e Transporteve si dhe Inspektoratin Qendror për të marrë referencat e distancave kilometrike brenda rrethit, të cilat nuk janë të publikuara zyrtarisht.

**b-** Në fletët e udhëtimeve të cilat janë dokumente që justifikojnë itinerarin e përshkruar, të vendosen destinacionet përfundimtare të udhëtimit dhe jo vetëm qendrat e qyteteve, si dhe çdo fletë udhëtimi të konfirmohet nga punonjësit udhëtues të autorizuar për inspektim.

*Menjëherë*

### **9. Gjetje nga auditimi**

Referuar faktit se nga ana DR Inspektoratit Fier janë në administrim 4 copë printerë të tipit hp OFFICEJET 150 Mobile All in-One, pajisje të marra nga donacione, të cilët kanë një normë pune shumë të vogël deri në 500 faqe në muaj dhe përdorin bojërash me kosto të lartë, për një menaxhim më të mirë të nevojave me një kohë të gjatë dhe kosto më të ulët, *sa trajtuar në faqet 72-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:*

-Nga DR ISHMP Fier, për efekt të plotësimit të nevojave me pajisje dhe materiale, në plotësim të tre kriterëve: efikasitet, ekonomikitet dhe efektivitet, në një kohë kur kostoja aktuale e printerit si pajisje shpesh herë është më e vogël nga vlera e bojërave, referuar një analize kostoje dhe në bashkëpunim me specialistë të fushë, të shikohet mundësia e zëvendësimit të printerëve me të tjerë më efektivë.

*Në vazhdim*

### **10. Gjetje nga auditimi**

Referuar faktit se në DR ISHMP Fier, nuk është kryer inventarizimi i dosjeve të personelit sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 05.03.2014, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” sipas lidhjes 1 dhe lidhjes 2, *sa trajtuar në faqet 68-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:*

-Nga sektori përkatës që mbulon burimet njerëzore në DR të ISHMP Fier të marren masa për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjitha të dhënat konform kërkesave ligjore dhe çdo dosje duhet të ketë inventarin e dosjes të konfirmuar nga palët.

**Menjëherë**

### **11. Gjetje nga auditimi**

Referuar konstatimit se në DR ISHMP Fier në dokumentet justifikues të shpenzimit në blerjet e vogla, nuk ndodhej dokumentacioni i cili vërtetonte llogaritjen e fondit limit, referuar dhe faktit të konstatuar, se në disa raste të llogaritjeve aktuale, fondi limit paraqitet me diferencë të konsiderueshme nga fondi i paraqitur nga ofertuesit pjesëmarrës në procedurë, *sa trajtuar në faqet 72-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:*

-Nga njësia e prokurimit të merren masat që llogaritja e fondit limit konform akteve në fuqi, të kryhet dhe dokumentohet si procedurë. Dokumentacioni argumentues i llogaritjes së fondit limit të jetë pjesë e praktikës së procedurës së prokurimit.

**Vazhdimisht**

### **12. Gjetje nga auditimi**

Referuar konstatimit nga auditimi se llogaritja e amortizimit të mjeteve të transportit dhe e pajisjeve kompjuter dhe printer të paraqitura në pasqyrat financiare të vitit 2014, nuk përkon me kohën në inventar dhe përqindjet e amortizimit të miratuara në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.14, datë 28.12.2006 “Për Përgatitjen dhe Raportimin e Llogarive Vjetore të vitit 2006, për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive të Menaxhim-Zbatimit të Projekteve e Marrëveshjeve me Donatorë të Huaj”, të ndryshuar, përkatësisht 13.8 % dhe 25 %, si dhe referuar faktit se shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore të paraqitura në pasqyrën e shpenzimeve “ Formulari 3/1”, nuk pasqyrojnë shpenzimet sipas situacionit vjetor faktik, për efekt të pasqyrimit konform rregullave të plotësimit të pasqyrave financiare dhe konform parimeve të kontabilitetit, *sa trajtuar në faqet 80-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:*

-Nga zyra e Financës së DR ISHMP Fier, të rillogaritet amortizimi sipas normativave të miratuara dhe të pasqyrohen efektet në pasqyrat financiare konform standardeve të kontabilitetit publik.

**Menjëherë**

### **13. Gjetje nga auditimi**

Nga auditimi i praktikave të inspektimit rezulton se një pjesë e programeve të inspektimit për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga veprimtaritë e paligjshme, nuk janë hartuar me afate dhe detyra konkrete, *sa trajtuar në faqet 11-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

#### ***Për këtë rekomandoj:***

-Kryeinspektori i DR ISHMP Fier, në bashkëpunim me përgjegjësin e sektorit të Inspektimit të Policisë Pyjore, të rishikojnë procedurën dhe metodologjinë për hartimin dhe miratimin e programeve të inspektimit në lidhje me pyjet, me objektiv ngritjen në një nivel më të lartë të mbrojtjes së mjedisit, duke u bazuar në vlerësimin të riskut.

**Menjëherë**

### **14. Gjetje nga auditimi**

Nga auditimi i autorizimeve të lëshuara për inspektime, për Sektorin e Inspektimit të Policisë Pyjore, Sektorin e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave, konstatohet se autorizimet nuk janë bërë sipas objektit dhe qëllimit të inspektimit referuar programit mujor të hartuar. Autorizimet gjithashtu, nuk janë plotësuar sipas elementëve të përcaktuara në përmbajtjen e autorizimit, veprime të cilat nuk përputhen me kërkesat e nenit 28 dhe 29 të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë, *sa trajtuar në faqet 11-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për këtë rekomandoj:***

-Kryeinspektori i DR-ISHMP Fier, mbështetur në rëndësinë që përfaqëson dokumentacioni i ndërmarrjes së inspektimit të marrë masa që, autorizimet që lëshohen për këtë qëllim, të jenë në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit. Gjithashtu autorizimet të lëshohen referuar programeve mujore të inspektimit të miratuara.

***Menjëherë***

**15. Gjetje nga auditimi**

Nga auditimi i rezultatit të inspektimeve të kryera nga Sektori i Inspektimit të Policisë Pyjore, Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave janë konstatuar një sërë problemesh e mangësish në dokumentimin, plotësimin e dokumentacionit të inspektimit dhe procedimin për kundërvajtjet në pyje, mjedis e ujëra. Në mbajtjen e procesverbaleve të inspektimit, procesverbaleve të konstatimit të kundërvajtjeve administrative si dhe vendimeve për dënim administrativ, shpesh herë mungon nënshkrimi i personit përgjegjës të kontrolluar dhe data e marrjes në dorëzim të kopjes së vendimit për dënim administrativ. Në rastin kur është kundërshtuar nënshkrimi i procesverbaleve dhe vendimit për dënim administrativ, nga ana e inspektorëve nuk është evidentuar ky fakt, veprime këto që nuk përputhen me kërkesat e pikës 2, neni 14 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", *sa trajtuar në faqet 11-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për këtë rekomandoj:***

-Inspektorët e Sektorit të Inspektimit të Policisë Pyjore dhe të Sektorit të Inspektimit të Mjedisit të marrin masa dhe të bëjnë plotësimet e nevojshme në dokumentacionin e mbajtur për kundërvajtjet administrative të rezultuara nga inspektimi, sipas kërkesave të ligjit.

***Menjëherë***

**16. Gjetje nga auditimi**

Nga auditimi i evidencës së grumbulluar rezulton se nga ana e Sektorit të Policisë Pyjore nuk ka asnjë të dhënë apo informacion në lidhje me procesverbalet e dëmit që i përcillen zyrtarisht pronarit të fondit pyjor (njësisë së qeverisjes vendore ose pronarit privat) që është dëmtuar të cilët e kanë detyrim të kërkojnë zhdëmtimin për dëmin e kryer ndaj tyre, dhe ku për ecurinë e procesit të zhdëmtimit, nga inspektorati kërkohet periodikisht informacion me shkrim, *sa trajtuar në faqet 11-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për këtë rekomandoj:***

-Kryeinspektori i DR ISHMP Fier, në bashkëpunim me Përgjegjësën e Sektorit të Inspektimit të Policisë Pyjore të kërkojnë periodikisht informacion në lidhje me marrjen e masave për

zhdëmtime dhe rehabilitimet e sipërfaqeve të dëmtuara. Për periudhat në vazhdim të programohet që ky proces të jetë i plotë dhe i vazhdueshëm.

*Deri më 31.03.2016*

### **17. Gjetje nga auditimi**

Nga auditimi i raportimeve ditore, dokumente që plotësohen nga ana e inspektorëve të Policisë Pyjore, pasi kanë kryer inspektimet, konstatohen pasaktësi dhe mangësi në plotësimin e tyre. Në disa raste data e plotësimit të raportit ditor nuk është e njëjtë me datën e inspektimit që kryhet, e përcaktuar në autorizim. Në këto raporte gjithashtu, nuk ka të dhëna për përcaktimin më të qartë të vendndodhjes së subjekteve të inspektuara si në rastet e inspektimeve rastësore, ashtu dhe të inspektimeve të programuara, *sa trajtuar në faqet 11-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

#### ***Për këtë rekomandoj:***

-Inspektorët e Sektorit të Inspektimit të Policisë Pyjore, të marrin masa për të plotësuar në mënyrë korrekte formularët e raportimeve ditore, sipas përcaktimeve dhe kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi.

*Menjëherë*

### **18. Gjetje nga auditimi**

Drejtoria e Shërbimit Pyjor Fier, ka konstatuar ndërhyrje të paligjshme në fondin pyjor dhe pasi ka mbajtur procesverbalet e konstatimit ia ka dërguar DR-ISHMPU Fier. Lidhur me këto informacione, nuk ka asnjë të dhënë nga Sektori i Inspektimit të Policisë Pyjore që të jetë vepruar për verifikimin dhe procedim sipas kërkesave të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", *sa trajtuar në faqet 11-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

#### ***Për këtë rekomandoj:***

-Sektori i Inspektimit të Policisë Pyjore në DR ISHMP Fier, të marrë masa për kryerjen e menjëhershme të inspektimeve, jashtë programit të miratuar, për informacionet e ardhura zyrtarisht nga DSHP Fier dhe të veprojnë në përputhje me kërkesat ligjore.

*Menjëherë*

### **19. Gjetje nga auditimi**

Në kompetencat dhe detyrat e Kryeinspektorit të Degës Rajonale Fier është përcaktuar që duhet të raportojë çdo muaj me shkrim tek Drejtorët e Drejtorive të Inspektimit në ISHMP sipas fushave përkatëse dhe t'i përcjellë raportimet e Sektorëve sipas modeleve të miratuara nga ky institucion, bashkëlidhur dhe kopje origjinale të procesverbaleve të konstatimit të kundërvajtjes dhe vendimeve të dënimit me gjobë. Nga auditimi rezulton që nuk është realizuar përcjellja e kopjeve origjinale të procesverbaleve të konstatimit të kundërvajtjeve dhe vendimeve të dënimit me gjobë, duke vepruar kështu në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.10279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative" si dhe të rregullores nr.1, datë 15.9.2014, me nr. prot. 1159, "Për organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror të mjedisit pyjeve dhe ujërave në nivel qendror dhe rajonal", *sa trajtuar në faqet 11-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

#### ***Për këtë rekomandoj:***

-Kryeinspektori i DR-ISHMP, Fier, të marrë masa për funksionimin e kontrolleve të brendshme në Institucion me qëllim plotësimin me korrektësi të kërkesave ligjore në ushtrimin e përgjegjësive e kompetencave në fushën e monitorimit, raportimit dhe komunikimit me Drejtoritë e Inspektimit përkatëse në ISHMP.

**Menjëherë**

### **20. Gjetje nga auditimi**

DR ISHMP Fier, për vitin 2014 deri më 31.8.2015 ka vendosur gjithsej 88 gjoba me vlerë 41,513,000, ku për vitin 2014 vlera e gjobave të vendosura është 33,430,000 lekë ndërsa për vitin 2015 vlera e gjobave është 8,083,000 lekë. Deri në momentin e auditimit nuk ka asnjë gjobë të arkëtuar. DR ISHMP Fier, nuk ka vepruar për vjeljen e gjobave për kundërvajtjet administrative, ku referuar procedurave ligjore pas marrjes së vendimit për dënim me gjobë dhe detyrimeve të tjera, si dhe plotësimit të gjithë procesverbaleve përkatëse, për kundërvajtjet administrative të konstatuara, duhej që mbas kalimit të afatit 30 ditor nga data e vendosjes së gjobës, të vazhdojë këtë proces në rrugë gjyqësore. Në rastet kur subjekti që është dënuar administrativisht, nuk ka shlyer vullnetarisht masën e gjobës, si dhe nuk ka bërë ankim administrativ, apo kërkesë padi në gjykatë, mbështetur në nenin 44, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, dhe nenit 46 të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për Inspektim në Republikën e Shqipërisë” inspektorati duhet të bëjë kërkesë në gjykatë për lëshimin e titullit ekzekutiv të gjobës. Gjithashtu dërgimi i informacionit në lidhje me subjektet ndaj të cilëve është marrë vendim për dënim administrativ drejtuar ISHMP Qendër dhe kërkesa nga ana e DR ISHMPU Fier, për emrat e subjekteve që nuk kanë bërë ankim administrativ pranë Komisionit të Ankimit në ISHMP, janë bërë me vonesë dhe jo në përputhje me afatet e përcaktuara sipas bazës ligjore, *sa trajtuar në faqet 11-64 të Raportit të Auditimit.*

### ***Për këtë rekomandoj:***

-Kryeinspektori i DR ISHMP Fier në bashkëpunim me juristin e Institucionit dhe strukturat përkatëse në ISHMP, të marrë masa për përcaktimin dhe ndjekjen e mënyrave efikase të shkëmbimit të informacionit me ISHMP dhe rritjen e bashkëpunimit kryesisht me Komisionin e Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative pranë ISHMP, mbi subjektet që kanë ankimuar brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për gjobën, me synim respektimin e afateve ligjore për ndjekjen në rrugë gjyqësore të proceseve administrative për nxjerrjen e urdhrin ekzekutiv të gjobave.

**Menjëherë**

### **21. Gjetje nga auditimi**

Në praktikat e dërguara në gjykatë për vendimet administrative të marra nga Sektori i Policisë Pyjore dhe Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave, vihen re mangësi në plotësimin e dokumentacionit sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” e cila ka sjellë për pasojë që, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin “Për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit” të vendosë rrëzimin e lëshimit të këtyre urdhrave ekzekutivi për 24 vendime për dënime administrative të Sektorit të Policisë Pyjore dhe 49 vendime administrative të Sektorit të inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave, pasi nuk rezulton që nga inspektorati të jenë paraqitur prova, për të provuar faktin nëse ndaj vendimeve të caktimit të gjobave të jetë ushtruar ose jo e drejta e ankimit. Gjithashtu edhe në rastin e nxjerrjes



nga ana e gjykatës kompetente të urdhrimit për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për 4 vendime të dënimit me gjobë, DR-ISHMP, Fier nuk ka dërguar me shkresë përcjellëse kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues përkatës për ekzekutim, Shoqërisë Përmbartimore përkatëse, konform rregullave dhe procedurave sipas kërkesave në nenet 9, 22, 23, 30 dhe 44 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", gjë që ka sjellë moszekutim vendimi dhe të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit në vlerën 320,000 lekë, *sa trajtuar në faqet 11-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për këtë rekomandoj:***

-Kryeinspektori i DR ISHMP Fier në bashkëpunim me zyrën juridike, të marrë masa për të mos lejuar mungesa dhe mangësi dokumentacioni dhe provash në praktikat administrative, të cilat i përcillen gjykatës për nxjerrjen e urdhrave ekzekutiv, si dhe të ndjekë në vazhdimësi proceset gjyqësore, me qëllim ndjekjen deri në fund të zbatimit të akteve administrative, që kanë të bëjnë me gjoba, dhe vjeljen e tyre brenda afateve të përcaktuara.

***Në vazhdimësi***

***22. Gjetje nga auditimi***

Nga auditimi është konstatuar se Sektorët e Mjedisit dhe Ujërave nuk disponojnë data bazë të dhënash për subjektet që ushtrojnë aktivitet në Qarkun e Fierit dhe subjekte që kanë ndikim në mjedis, ku mbi bazën e tyre të përcaktohen subjektet me riskt të lartë me ndikim në mjedis. Gjithashtu në këtë drejtim nuk ka komunikim zyrtar me institucione të tjera me të dhëna në këtë drejtim, *sa trajtuar në faqet 11-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për këtë rekomandoj:***

-DR-ISHMP Fier të marrë masa që dhe në bashkëpunim me institucione të tjera ( DR Tatimeve Fier, DRM) të krijojë një bazë të dhënash efektive, ku të hidhen në mënyrë të vazhdueshme informacioni i përditësuar dhe që shërben për të përcaktuar planin e inspektimeve mbi bazë risku.

***Menjëherë***

***23. Gjetje nga auditimi***

Nga auditimi ka rezultuar se nga inspektimi i kryer në 487 subjekte janë konstatuar mangësi në dokumentacion dhe ushtrim të aktivitetit pa leje të këtyre subjekteve dhe nga ana e inspektoratit nuk janë kryer ri inspektime për verifikim detyrash të lëna, veprim në kundërshtim nenin 48 të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011“ Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, *sa trajtuar në faqet 11-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për këtë rekomandoj:***

-Nga ana e sektorëve të inspektimit të DR ISHMP Fier, të merren masa që për të gjitha subjektet, që rezultojnë me mangësi në dokumentacion dhe ushtrim të aktivitetit pa leje, të veprohet konform përcaktimeve ligjore dhe për rastet e moszbatimit të detyrimeve të zbatohet dënimet administrative që parashikon ligji nr. 10 433, datë 16.6.2011“ Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

***Vazhdimisht***

***24. Gjetje nga auditimi***

Referuar konstatimit se nga 35 ankesa të protokolluara, vetëm për 13 ankesa është lëshuar autorizim për inspektim nga Kryeinspektori dhe ku vetëm për një ankesë ka rezultuar kthim

përgjigje dhe për 22 ankesa të tjera nuk ka shqyrtim dhe inspektim, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “ Për Arkivat” dhe Ligjin 8485, datë 12.05.1999 “Kodi Procedurës Administrative”, *sa trajtuar në faqet 11-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:*

- Nga K/Inspektori i DR ISHMP Fier të ndiqen të gjitha procedurat ligjore në shqyrtimin dhe inspektimin e ankesave, për nxjerrjen dhe përcaktimin e përgjegjësive të shkelësve përkatës të ligjit.

*Vazhdimisht*

### **25. Gjetje nga auditimi**

Nga auditimi i planeve të punës dhe proces verbalët e mbajtura nga inspektorët, u konstatua se nuk ka një ndarje të zonave për inspektorët. Ndarja e punës rezulton të jetë rutinë e ndarjes ditore të punës pa përcaktuar përgjegjësitë individuale të zonave të inspektuara . Për efekt të një menaxhimi më të mirë të punës inspektuese si dhe për efekt të rritjes së përgjegjshmërisë në inspektim për zonën nën mbikëqyrje, *sa trajtuar në faqet 11-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandoj:*

-Për efekt të rritjes së përgjegjësive të inspektimit, kontrollit dhe menaxhimit, për arritjen e objektivave dhe realizimit të funksioneve institucionale, nga Kryeinspektori të bëhet një organizim me ndarje të zonave të inspektimit për inspektorët, për efekt të nxjerrjes së përgjegjësive individuale të punonjësve për subjektet që vazhdojnë të punojnë pa dokumente të rregullta, pa leje mjedisore, dhe të ndotësve të mjedisit.

*Menjëherë*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

1. Të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e shumës së dëmit ekonomik **prej 329,057 lekë** të shkaktuar nga Komisioni i vendosjes së normativave të karburantit( i përbërë nga ..... me detyre shofer, ..... me detyrë ish specialist Jurist i institucionit,..... specialist i jashtëm i fushës, Inxhinier Mekanik) si rezultat i vendosjes së normativave të konsumit të karburantit /për 100 km për dy mjetet në përdorim, jo konform procedurave të dokumentuara dhe që argumentojnë normativat e rezultuara.(mbajtur procesverbal i dt.6.11.2015)

*Menjëherë*

2. Të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e shumës së dëmit ekonomik **prej 60,220 lekë në total** si rezultat i përfitimit të karburantit nga kilometrat e vendosura me tepër krahasuar me kilometrat e përcaktuara të distancave të miratuara dhe në fuqi, si më poshtë vijon:

-Shuma në **vlerën 28,206 lekë** nga ..... me detyre shofer

-Shuma në **vlerën 18,792 lekë** nga përfituesi ..... me detyrë inspektor , përdorues mjeti.

-Shuma në **vlerën 13,222 lekë** nga përfituesi ..... me detyrë inspektor, përdorues mjeti.  
(mbajtur procesverbal i dt.6.11.2015)

*Menjëherë*

3. Të kontabilizohen dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e shumave ***në vlerën 350,600 lekë*** nga 6 punonjës (sipas listës bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit), vlerë e materialeve të përdorura jo konform procedurave dhe normativave. Kjo shumë ka rezultuar si diferencë midis faktit të bojës së harxhuar prej 130 copë çift bojërash (boje e zezë + tri kolor) për periudhë Dhjetor 2014 deri më 31.08.2015 për 4 printera dhe normatives së përdorimit të bojës së printerëve mbështetur dhe në normën e punës së mundshme të printerëve për periudhën e përdorimit në institucion.(mbajtur procesverbal i dt.10.11.2015).

***Menjëherë***

4. Të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e shumës së dëmit ekonomik ***prej 10,988.4 lekë në total***, të konstatuar paraprakisht nga përmbledhësja e detyrimeve të vënë në dispozicion nga DR ISHMP Fier, për kamat vonesat e vendosura nga OSHEE, si rezultat i mospagimit të detyrimeve për energjinë elektrike për vitin 2014 dhe 2015, ku kamatat për këtë ***periudhë janë 1,120.3 lekë për vitin 2014 dhe 9,868.1 lekë për vitin 2015***. Këto detyrime të paguhen nga personat përgjegjës.( mbajtur aktverifikimi i dt. 10.11.2015).  
*Sa trajtuar në faqet 72-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

### **C. MASA DISIPLINORE**

#### **Për Kompetencë të ISHMP Tiranë**

***CI. Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, nenit 57 si dhe nenit 59 të ligjit , gjithashtu mbështetur në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, mbështetur dhe në ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, nenin 44 të ligjit “ Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”, do të kërkonim të fillonin procedurat për dhënien e masës disiplinore:***

***-Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga detyra” në bazë të analizës për rezultatet e auditimit të paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit në DRISHMP Fier për:***

***a. .... me detyrë Kryeinspektor i DR-ISHMP Fier për arsye se:***

***- Nuk janë respektuar afatet ligjore si dhe janë dërguar me vonesë kërkesat për lëshimin e urdhrit ekzekutiv pranë Gjykatës Administrative të rrethit Gjyqësor Vlorë pas kalimit të afatit 30 ditore nga data e vendosjes së saj, sipas përcaktimeve në nenin 44, të ligjit nr. 10279, dt 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, dhe nenit 46 të ligjit nr. 10433, dt 16.6.2011, “Për Inspektim në Republikën e Shqipërisë” .***

***- Në praktikat e dërguara në gjykatë, vihen re mangësi në dokumentacion sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” e cila ka sjellë për pasojë që me Vendimet përkatëse të Gjykatës Administrative të rrethit Gjyqësor Vlorë, “Për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit” të vendoset rrëzimi i lëshimit të këtyre urdhrave ekzekutimi pothuajse për të gjitha vendimet për dënime administrative, pasi nuk rezulton që nga***

pala kërkuese të jenë paraqitur prova për të provuar faktin nëse ndaj vendimeve të caktimit të gjobave të jetë ushtruar ose jo e drejta e ankimit.

- Pas nxjerrjes nga ana e gjykatës kompetente të urdhrimit për ekzekutimin e titullit ekzekutiv të 4 vendimeve të dënimit me gjobë, nuk është dërguar me shkresë përcjellëse kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues përkatës për ekzekutim Shoqërisë Përmbartimore përkatëse, konform rregullave dhe procedurave sipas neneve 9, 22, 23, 30 dhe 44 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", e cila ka sjellë për pasojë të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit në vlerën **320,000 lekë**, si rezultat i mos vjeljes së gjobave.

- Në lidhje me 3 vendimet e tjera të dënimeve me gjobë: (Vendim nr. 2, datë 24.7.2014, me nr. serie 0000632, përcjellë në Gjykatën Administrative Vlorë me shkresë nr. 419, datë 18.6.2015; Vendim nr. 6, datë 9.9.2014, me nr. serie 0000633, përcjellë në Gjykatën Administrative Vlorë me shkresë nr. 418, datë 18.6.2015 dhe Vendim nr. 8, datë 15.9.2014, me nr. serie 0002341, përcjellë në Gjykatën Administrative Vlorë me shkresë nr. 420, datë 18.6.2015) nuk është ndërmarrë asnjë veprim për ndjekje dhe marrje informacioni nëse ka vendim nga ana e gjykatës për këto kërkesa.

- Gjithashtu nga auditimi është konstatuar se nga 35 ankesa të protokolluara vetëm për 13 ankesa është lëshuar autorizim për inspektim nga Kryeinspektori dhe ku vetëm për një ankesë ka rezultuar kthim përgjigje dhe për 22 ankesa të tjera nuk ka shqyrtim dhe inspektim, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat" dhe Ligjin 8485, datë 12.05.1999 "Kodi Procedurës Administrative".

- Një pjesë e programeve të inspektimit për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga veprimtaritë e paligjshme nuk janë hartuar për inspektime me afate dhe detyra konkrete.

- Në disa raste autorizimet e lëshuara për inspektime nuk janë bërë sipas objektit dhe qëllimit të inspektimit të programit mujor të hartuar.

- Autorizimet në përgjithësi nuk janë plotësuar sipas elementëve të përcaktuara në përmbajtjen e autorizimit. Në autorizimet e lëshuara nuk është përcaktuar kohëzgjatja e autorizimit, veprime këto në kundërshtim me nenin 28 dhe 29 të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

- Nuk është vepruar sipas kërkesave të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" për verifikimin dhe procedimin më tej, për procesverbalet e konstatimit të ardhura nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor Fier e cila ka konstatuar ndërhyrje të paligjshme në fondin pyjor.

- Nuk ka plotësuar detyrimin sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10279, dt 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative" si dhe rregullores nr. 1, dt 15.9.2014, me nr. prot 1159, "Për organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror të mjedisit pyjeve dhe ujërave në nivel qendror dhe rajonal" pasi nuk ka raportuar çdo muaj me shkrim tek Drejtorët e Drejtorive të Inspektimit sipas fushave përkatëse dhe nuk ka përcjellë raportimet e sektorëve sipas modeleve të miratuara nga ISHMP, si dhe një kopje origjinale të procesverbaleve të konstatimit të kundërvajtjes dhe vendimeve të dënimit me gjobë.

*C2. Mbështetur në nenin 58 "llojet e masave disiplinore", të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", nenit 57 si dhe nenit 59 të ligjit , gjithashtu mbështetur në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", do të kërkohet të fillonin procedurat për dhënien e masës disiplinore:*

**-“Mbajtja 1/3 e pagës së plotë për një periudhë tre mujore” neni 58, germa b, për:**

**a....., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit të Mjedisit për:**

-Për detyrat e lëna nga sektori i Inspektimit të Mjedisit, janë ri kontrolluar 332 subjekte, për kontrollin e zbatimit të detyrave të lëna, për subjektet që kanë pasur mangësi në dokumentacion dhe ushtrim të aktivitetit pa leje dhe për këto ka rezultuar se kanë aplikuar vetëm 62 subjekte, *ngelen të pa pajisur me leje dhe dokumentacion të rregullt 286 subjekte. Për 286 subjekte, që kanë pasur mangësi në dokumentacion dhe ushtrim të aktivitetit pa leje duhet të ishte vepruar në zbatim të nenin 4, pika 2, neni 26, pika 2, dhe pika 3, germa c, neni 27, pika 1,2 dhe 3, dhe neni 48. Pikat 1, 2, 4,5 dhe 6, ku citohet: Mos korrigjimi i parregullsive brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 4 të këtij neni, përbën, veçmas, kundërvajtje administrative dhe dënimi kryesor mund të shoqërohet me dënim plotësues, gjobë në vlerë nga 10 000 deri në 100,000 lekë, që i referohet ligjit 10 433, datë 16.6.2011“ Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.*

-Për 37 proces verbale për konstatimin e Kundërvajtjeve Administrative dhe në Vendimet për Dënimin Administrativ, për personat që është mbajtur, nuk vërtetohet që është mbajtur në prani të tyre apo në mungesë, mbasi në të dy rastet, si Proces Verbalet për Konstatimin e Kundërvajtje Administrative dhe për Dënim Administrativ tek personi përgjegjës i kontrolluar nuk ka plotësim të rubrikës , veprim që bie në kundërshtim me nenin 24, pika 1, neni 25 dhe 26 pika 1,2 dhe 3 të ligjit 10279, datë 20.05.2010 “ Për kundërvajtjet Administrative”. Kjo gjë ka sjell dhe rrëzimin e tyre për Lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë. Gjithashtu mosplotësimi konform ligjit bie ndesh dhe me vet kriteret e plotësimit të proces verbaleve standarde të miratuara për konstatimin e kundërvajtjeve administrative dhe vendimet për dënim administrativ.

-Nga auditimi i planeve të punës dhe proces verbalet e mbajtura nga inspektorët u konstatua se nuk ka një ndarje të zonave për inspektorët. Ndarja e punës rezulton të jetë rutinë e ndarjes ditore të punës, pa përcaktuar përgjegjësitë individuale dhe të zonave të inspektuara .

**C3.** Për inspektorët e Sektorit të Ujërave pranë DR ISHMP Fier, të cilët kanë kaluar gjatë vitit 2015 në vartësi të Ministrisë të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në ABU Fier, i lihet në kompetencë të ISHMP *ti përcjellë masat disiplinore të përcaktuara, referuar konstatimeve në Raportin Përfundimtar të Auditimit të DR ISHMP Fier, “Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave” si më poshtë:*

*Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, nenit 57 si dhe nenit 59 të ligjit , gjithashtu mbështetur në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, do të kërkonim të fillonin procedurat për dhënien e masës disiplinore:*

**-“Mbajtja 1/3 e pagës së plotë për një periudhë tre mujore” neni 58, germa b, për:**

**a. .... me detyrë, përgjegjës i Sektorit të Inspektimit të Ujërave.**

Për arsyet :

-nuk janë planifikuar inspektime për kontrollin e zbatimit të detyrave të lëna për subjektet që kanë pasur mangësi në dokumentacion dhe ushtrim të aktivitetit pa leje.

- nuk është bërë asnjë akt konstatimi për të ri kontrolluar zbatimin e detyrave të lëna nga inspektorët.

-Për vitin 2015, nuk është lëshuar asnjë autorizim inspektimi.

- Nga 16 gjobat në vlerën 17,000,000 lekë, nuk ka arkëtime sipas procedurës dhe nga Gjykata e Shkallës së Parë nuk janë nxjerrë titujt ekzekutive, për arsye se në procesverbalet për Konstatimin e Kundërvajtjeve Administrative dhe në Vendim për Dënimin Administrativ për personat që është mbajtur nuk vërtetohet që është mbajtur në prani të tyre apo në mungesë, veprim në kundërshtim me nenin 24, pika 1, neni 25 dhe 26 pika 1, 2 dhe 3 të ligjit 10279, datë 20.05.2010 “ Për kundërvajtjet Administrative”, pra nuk është ndjekur procedura konform kërkesave ligjore.

**“Vërejtje” neni 58 , germa a, për:**

*a. .... me detyrë inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ujërave.*

*b. .... me detyrë inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ujërave.*

*Për arsyet se:*

- Nga subjektet e inspektuara gjatë vitit 2014 që kanë rezultuar me kundërvajtje administrative, rezulton se për procedurat e konstatimit dhe të shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, në mbajtjen e procesverbaleve të inspektimit; procesverbaleve të konstatimit të kundërvajtjeve administrative si dhe vendimeve për dënim administrativ, mungon nënshkrimi i personit përgjegjës të kontrolluar dhe data e marrjes së kopjes së vendimit për dënim administrativ. Në rastin kur është kundërshtuar nënshkrimi i procesverbaleve dhe i vendimit për dënim administrativ, nga ana e inspektorëve, nuk është evidentuar ky fakt, veprim ky në kundërshtim me pikën 2, neni 14 të ligjit nr. 10279 dt 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

*Për kompetencë DR ISHMP Fier*

*C4. Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, nenit 57 , nenit 59 të ligjit , gjithashtu mbështetur në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikes në administratën publike”, i rekomandojmë Titullarit direkt të filloj procedurat për dhënien e masës disiplinore:*

**“Vërejtje” neni 58, germa a për:**

*a. .... me detyrë Inspektor i Policisë Pyjore;*

*b. .... me detyrë Inspektor i Policisë Pyjore;*

*c. .... me detyrë Inspektor i Policisë Pyjore;*

*d. .... me detyrë Inspektor i Policisë Pyjore;*

*e. .... me detyrë Inspektor i Policisë Pyjore:*

*Për arsye se:*

- Nga subjektet e inspektuara gjatë vitit 2014 dhe deri më 31.8.2015, që kanë rezultuar me kundërvajtje administrative, rezulton se për procedurat e konstatimit dhe të shqyrtimit të

kundërvajtjeve administrative, në mbajtjen e procesverbaleve të inspektimit; procesverbaleve të konstatimit të kundërvajtjeve administrative si dhe vendimeve për dënim administrativ, mungon nënshkrimi i personit përgjegjës të kontrolluar dhe data e marrjes së kopjes së vendimit për dënim administrativ. Në rastin kur është kundërshtuar nënshkrimi i procesverbaleve dhe i vendimit për dënim administrativ, nga ana e inspektorëve, nuk është evidentuar ky fakt, veprim ky në kundërshtim me pikën 2, neni 14 të ligjit nr. 10279 dt 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

- Në lidhje me raportimet ditore, që plotësohen nga ana e inspektorëve të Policisë Pyjore, pasi kanë kryer inspektimet, në bazë të autorizimeve përkatëse, vihen re pasaktësi dhe mangësi në plotësimin e këtyre raporteve si: - në disa raste data e plotësimit të raportit ditor nuk është e njëjtë me datën e inspektimit që do të kryhet, e përcaktuar në autorizim; - nuk ka të dhëna për përcaktimin më të qartë në lidhje me vendndodhjen e subjekteve të inspektuara si në rastet e inspektimeve rastësore ashtu dhe në ato të programuara.

- Sektori i Inspektimit të Policisë Pyjore nuk ka marrë në konsideratë të gjitha informacionet që janë dërguar nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor Fier pasi kanë konstatuar ndërhyrje të paligjshme në fondin pyjor, duke mos bërë verifikimin dhe procedimin sipas kërkesave të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

*C5. Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, nenit 57 si dhe nenit 59 të ligjit , gjithashtu mbështetur në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, i rekomandojmë Titullarit direkt të fillonte procedurat për dhënien e masës disiplinore:*

**” Vërejtje ” neni 58 gërma a , për Inspektorët e Mjedisit.**

**a. ...., me detyrë inspektor i Sektorit të inspektimit të mjedisit**

**b. ...., me detyrë inspektor i Sektorit të inspektimit të mjedisit**

**c. ...., me detyrë inspektor i Sektorit të inspektimit të mjedisit**

**d. ...., me detyrë inspektor i Sektorit të inspektimit të mjedisit**

**e. ...., me detyrë inspektor i Sektorit të inspektimit të mjedisit**

**f. ...., me detyrë inspektor i Sektorit të inspektimit të mjedisit**

**g. ...., me detyrë inspektor i Sektorit të inspektimit të mjedisit**

**h. ...., me detyrë inspektor i Sektorit të inspektimit të mjedisit**

*Për arsyet:*

- Nga subjektet e inspektuara gjatë vitit 2014 dhe deri më 31.8.2015, që kanë rezultuar me kundërvajtje administrative, rezulton se për procedurat e konstatimit dhe të shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, në mbajtjen e procesverbaleve të inspektimit; procesverbaleve të konstatimit të kundërvajtjeve administrative si dhe vendimeve për dënim administrativ, mungon nënshkrimi i personit përgjegjës të kontrolluar dhe data e marrjes së kopjes së vendimit për dënim administrativ. Në rastin kur është kundërshtuar nënshkrimi i procesverbaleve dhe i vendimit për dënim administrativ, nga ana e inspektorëve, nuk është evidentuar ky fakt, veprim ky në kundërshtim me pikën 2, neni 14 të ligjit nr. 10279 dt 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

**Shënim:**

Për..... me detyrë ish-jurist, ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, rezulton se kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës. *Për këtë punonjës nuk është propozuar masë disiplinore, pasi masa ndaj tij konsiderohet e ezauruar. Masa e propozuar do të ishte:*

***“Largim nga detyra ” për:***

.....me detyrë ish-jurist pasi për vitin 2014, rezulton se, për vjeljen e gjobave për kundërvajtjet administrative pas marrjes së vendimit për dënim me gjobë nuk ka ndjekur rrugën gjyqësore për lëshimin e titullit ekzekutiv të gjobës pas kalimit të afatit 30 ditor nga data e vendosjes së gjobës sipas përcaktimeve në nenin 44, të ligjit nr. 10279, dt 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, dhe nenit 46 të ligjit nr. 10433, dt 16.6.2011, “Për Inspektim në Republikën e Shqipërisë” ku, në rastet kur subjekti që është dënuar administrativisht, person fizik/juridik, publik/privat, nuk ka shlyer vullnetarisht masën e gjobës, si dhe nuk ka bërë ankim administrativ, apo kërkesë padi në gjykatë, duhet të bëhet kërkesë në gjykatë për lëshimin e titullit ekzekutiv të gjobës.

- Për mos respektim të afateve ligjore dhe dërgimit me vonesë të kërkesave për lëshimin e urdhrat ekzekutiv pranë Gjykatës Administrative të rrethit Gjyqësor Vlorë.

Mbështetur në ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” nenin 44 të ligjit “ Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”, ku citohet se: “ *Në rast se gjobat dhe detyrimet e tjera, të vendosura nga vendimi për kundërvajtjen administrative nuk paguhen për mosveprim të punonjësit të organit administrativ i cili ka miratuar vendimin përkatës dhe detyrimin që të kërkojë arkëtimin e shumave, apo për shkak se punonjësi nuk nis procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ, atëherë ndaj tij fillojnë procedurat e largimit nga detyra.*”

-Për ..... me detyrë ish-përgjegjës i Sektorit të Policisë Pyjore, si dhe për ..... dhe ..... me detyrë Inspektorë të Policisë Pyjore të cilët janë ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar, rezultojnë se kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës. *Për këto punonjës nuk është propozuar masë disiplinore, pasi masa ndaj tyre konsiderohet e ezauruar. Masa e propozuar do të ishte:*

***- “Vërejtje” për:***

..... me detyrë ish-përgjegjës i Sektorit të Policisë Pyjore Inspektori i Policisë Pyjore;

..... me detyrë ish-Inspektori i Policisë Pyjore;

..... me detyrë ish-Inspektori i Policisë Pyjore;

*Për arsyet se :*

- Nga subjektet e inspektuara gjatë vitit 2014 dhe deri më 31.8.2015, që kanë rezultuar me kundërvajtje administrative, rezulton se për procedurat e konstatimit dhe të shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, në mbajtjen e procesverbaleve të inspektimit; procesverbaleve të konstatimit të kundërvajtjeve administrative si dhe vendimeve për dënim administrativ, mungon nënshkrimi i personit përgjegjës të kontrolluar dhe data e marrjes së kopjes së vendimit për dënim administrativ. Në rastin kur është kundërshtuar nënshkrimi i procesverbaleve dhe i vendimit për dënim administrativ, nga ana e inspektorëve, nuk është evidentuar ky fakt, veprim ky në kundërshtim me pikën 2, neni 14 të ligjit nr. 10279 dt 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

- Në lidhje me raportimet ditore, që plotësohen nga ana e inspektorëve të Policisë Pyjore, pasi kanë kryer inspektimet, në bazë të autorizimeve përkatëse, vihen re pasaktësi dhe mangësi në



plotësimin e këtyre raporteve si: - në disa raste data e plotësimit të raportit ditor nuk është e njëjtë me datën e inspektimit që do të kryhet, e përcaktuar në autorizim; - nuk ka të dhëna për përcaktimin më të qartë në lidhje me vendndodhjen e subjekteve të inspektuara si në rastet e inspektimeve rastësore ashtu dhe në ato të programuara.

- Sektori i Inspektimit të Policisë Pyjore nuk ka marrë në konsideratë të gjitha informacionet që janë dërguar nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor Fier pasi kanë konstatuar ndërhyrje të paligjshme në fondin pyjor, duke mos bërë verifikimin dhe procedimin sipas kërkesave të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

( për sa përcaktuar në masat disiplinore janë mbajtur procesverbalet me nr. 631,datë 7.10.2015; nr.688, datë 23.10.2015; nr.713, datë3.11.2015; nr.737, datë 11.11.2015)

*Shënim:* Auditimi u krye nga audituesit Nikoleta Piranjani, Piro Imeraj, Genta Brahja, Valdete Berisha, Albert Thoma, më tej u shqyrtua nga k/auditues Yllka Pulashi, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Departamentit Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj.